

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 07/11/2018 (dymije e tetembehjete), u redaktua kontrata e shitjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise MUSA ALBANIA SHPK person juridik shqiptar rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS :L81821024M u paraqiten personat e identifikuar si ne vijim:

SHITESI kuotave:

- **BLG shpk**, me seli ne Rr. Tercilio Kardinali, Njesia nr. 11, ndertesa 10, kati 2, shkalla 1, ap. 2, me NIPT L71603025P, e perfaqesuar nga perfaqesuesi i saj ligjor, **Z. Massimiliano Nicolini**, shtetas italian, i datelindjes 16.11.1976, lindur ne Brescia (Itali) me banim ne Tirane, madhor me zotësi te plote juridike,dhe për të vepruar, i pajisur me pasaporte nr. YA 1831944, e vlefshme deri me 01.03.2021, ne cilesine e ortakut te shoqerise Musa Albania sh.p.k , ne vijim "Shitesi";

BLERESI kuotave:

- "**ORIZZONTI INTERNAZIONALI " S.R.L**, shoqeri tregtare Italiane me seli ligjore ne adresen : Via Don Gnocchi 8 Presezzo , e rregjistruar me NUIS: **07111340969** e perfaqesuar nga vete administratori **Z. Fabio Verzeri** i biri i Angelo-s lindur ne BERGAMO (MT) , ne 12/02/1960 banues ne Vittorio Veneto ,333 Presezzo person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar indentifikuar me mjetin e identifikimit Nr. YA 8609707 leshuar nga komuna Presezzo ne date 14/10/2015 me vendodhje dhe detyre prane selise qendrore te shoqerise , ne vijim "Bleresi";

Parashtruar qe:

- a) Shoqeria" Musa Albania " Shpk regjistruar si shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit QKR ne date 21/06/2018 dhe Nipt L81821024M. Ortaket kane te gjithë fuqine dhe autoritetin per te ekzekutuar dokumentat e transaksionit dhe kane ne zoterim kuotat si vijojne.
 - BLG sh.p.k zoteron 1 kuote e cila perben 75 % te kapitalit themeltar me vlere 19.500.000
 - Ente Fiera Sh.a zoteron 1 kuote e cila perben 15 % te kapitalit themeltar me vlere 3.900.000 leke ,

- Albastep shpk zoteron 1 kuote e cila perben 5 % te kapitalit themeltar me vlere 1.300.000 leke ,
- Moditech s.r.l zoteron 1 kuote e cila perben 5 % te kapitalit themeltar me vlere 1.300.000 leke ,

Sa me sipër u parashtrua është pjese integrale e kësaj kontrate.

Palët si me sipër me vullnetin e tyre te lire vendosin si vijon:

Neni 1 Objekti kontratës

Ortaku themelues shoqeria BLG shpk vendos ti shesë 1 kuote e cila perben 2% te kapitalit te shoqerise me vlere 520.000 leke qe zotëron ne Shoqëri Musa Albania Shpk , Blerësve si ne vijim:

- Shoqeria ORIZZONTI INTERNAZIONALE S.R.L , I cili pranon te bleje kuotat qe shitesi zoteron ne Shoqerine Musa Albania sh.p.k.

Neni 2 Çmimi dhe pagesa

2.1 Çmimi i caktuar për shitjen e kuotave te shoqërisë është vlerësuar ne baze te vleres se kapitalit, si pasoje shitësi shet kuotat blerësve si vijon:

- Shoqeria ORIZZONTI INTERNAZIONALE S.R.L , i blen kuotat ne masën 2% te kapitalit me vlere 520.000 leke.

Neni 3 Pronësia dhe transferimi i kuotave

3.1 Pala shitëse i garanton palët blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj te treteve dhe për çdo pretendim qe mund te ngrëne te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palëve blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbroju te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

3.2 Pronësia e kuotave i transferohet blerësve ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate shitblerje. Nga ky moment blerësit i transferohet pronësia e kuotave dhe si pasoje shoqëria do te ketë si ortakë personat si vijojnë:

- Shoqëria BLG shpk , zotëron 73 % te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote me vlere nominale 18.980.000 leke .

- Shoqëria Ente Fiera sha , zotëron 15 % te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote me vlere nominale 3.900.000 leke;

-Shoqëria Albastep , zotëron 5 % te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote me vlere nominale 1.300.000 leke;

-Shoqëria MODITECH SRL , zotëron 5 % te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote me vlere nominale 1.300.000 leke;

-Shoqëria "ORIZZONTI INTERNAZIONALE " S.R.L, zotëron 2 % te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote me vlere nominale 520.000 leke

Sa parashikuar ne dispozitat kontraktuese te mësipërme, ne përputhje me nenin 686 te Kodit Civil Shqiptar, Blerësit deklarojnë se pranojnë dhe miratojnë veçmas Nenin 2 (Çmimi dhe pagesa).

Me nënshkrimin e kesaj kontrate , shitesit , shoqëria BLG shpk ortak themelues i shoqërisë Musa Albania Shpk zhvishet nga pronësia e 1 koute me perqindje 2% te kapitalit themeltar dhe bleresi "ORIZZONTI INTERNAZIONALE " S.R.L behet zoterues i nje kuote me perqindje 2% te kapitalit fillestar.

PALET KONTRAKTUESE



PALA SHITese

BLG SHPK

Z. Massimiliano Nicolini



PALA BLERese

ORIZZONTI INTERNAZIONALI SRL

Z.FABIO VERZERI

Orizzonti Internazionali sri

Società a socio unico
Sede Legale : Via Don Gnocchi 8 - 24030 Presezzo
CF e P.IVA : 07111340969
REA : BG - 424173
Capitale sociale 10.000 € i.v.